



QENDRA MULTIFUNKSIONALE  
POGRADEC sh.a

**QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC SH.A  
ADMINISTRATORI**

Nr. 147/Prot.  
2

Pogradec, më 26.09.2022

**THIRRJE E HAPUR PUBLIKE, FAZA II  
PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E  
PROJEKT PROPOZIMEVE.**

Bashkia Pogradec, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.109, datë 02.12.2021, "Për themelimin e shoqërisë "Qendra multifunkionale Pogradec sh.a" dhe miratimin e aktit të themelimit", dhe Vendimit Nr.110, datë 02.12.2021, "Per miratimin e statutit të shoqërisë "Qendra multifunkionale Pogradec sh.a", të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën Nr. 1196/1 prot, datë 14.12.2021, krijuan **SHOQËRINË AKSIONERE QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC sh.a.**

Një ndër qëllimet kryesore të krijimit të kësaj shoqërie aksionere është bashkëpunimi me shoqërinë civile, me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Pogradec.

Në këtë kuadër Shoqëria Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a, me miratimin paraprak nga Bashkia Pogradec, po harton dhe publikon këtë thirrje në menyrë që çdo aktor i shoqërisë publike të paraqesë projekt propozimet e veta në fushën: Art, Kulturë, Sport, Trashëgimi kulturore, Promovimi i Vlerave qytetare Pogradecare, Film .. etj

Thirrja financohet plotësisht nga buxheti i Bashkisë Pogradec, për vitin 2022.

Për sa më sipër, Shoqëria Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimore dhe prioritetet, si më poshtë:

- 1. Organizimi i aktiviteteve që synojnë organizimet festive kulturore argëtuese, që favorizojnë rritjen e zhvillimin e jetës kulturore në territorin e Bashkisë Pogradec.*
- 2. Organizimi i aktiviteteve që synojnë promovimin e ngjarjeve kulturore që favorizojnë zhvillimin e turizmit në territorin e Bashkisë Pogradec.*
- 3. Organizimi i aktiviteteve artistike, që favorizojnë rritjen e zhvillimin e jetës artistike, filmike dhe kulturore në territorin e Bashkisë Pogradec.*
- 4. Promovimi i resurseve natyrore, kulturore, figurave të shquara të qytetit të Pogradecit, promovimi i vlerave qytetare dhe produktit vendor të Bashkisë Pogradec.*
- 5. Promovimi dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive të rinjve në aktivitete sportive, kulturore dhe sociale, si aktorë thelbësorë në jetën qytetare të Qytetit të Pogradecit.*

Organizatat e Shoqërisë Civile mund të aplikojnë me jo më shumë se një projekt propozim si aplikues ose si partner. Çdo projekt propozim, do të shqyrtohet dhe vleresohet nga Komisioni i Vleresimit të Projekteve.

Komisioni i Vleresimit të Projekteve, rezervon të drejtën të mos miratojë një projekt propozim, në rast se nuk është në përputhje me kriteret e kësaj thirrje, të dokumentacionit detyrues apo objektivave që ka përcaktuar Bashkia Pogradec.

Komisioni i Vleresimit të Projekteve, rezervon të drejtën të miratojë projekt propozimet brenda buxhetit të thirrjes së miratuar.

Komisioni i Vleresimit të Projekteve, rezervon të drejtën të skualifikojë projekt propozimet e mbetura, në tejkalimin të vlerës të buxhetit të miratuar.

Qendra Multifunktionale Pogradec, rezervon të drejtën të mos i alokojë fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e miratuara nuk i realizojnë projektet sipas dokumentacionit të paraqitur në konkurrim.

Kohëzgjatja e secilit projekt mund të shkojë nga 1 ditë deri në 9 muaj.

Projektet e përzgjedhura duhet të zbatohen në periudhën maksimale deri në **Dhjetor 2022**.

#### **PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:**

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OShC-të e regjistruara zyrtarisht (**shoqata/organizata apo fondacion si dhe persona fizikë dhe juridike/shoqëri**) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e në fuqi në Shqipëri. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë.

#### **BUXHETI I THIRRJES:**

Thirrja financohet plotësisht nga buxheti i Bashkisë Pogradec, për vitin 2022.

Vlera e buxhetit të kësaj thirrje për financimin e projekt propozimeve është **2 000 000 (Dy milion)** lekë

#### **DOKUMENTACIONI:**

Të gjitha informatat e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në web-faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec ([www.bashkiapogradec.gov.al](http://www.bashkiapogradec.gov.al)).

Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, bashkia do të organizojë takime informuese/ditë të hapura:

Q.M.P dhe Bashkia Pogradec do të organizojë një takim informues/ditë të hapur mbi Thirrjen e hapur, ku ftohen të marrin pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në përgjigje të kësaj Thirrjeje. Ky takim ka si qëllim, informimin e OSHC-ve mbi elementët kryesorë të Thirrjes, duke u fokusuar tek elementët më të rëndësishëm për OSHC-të.

Më shumë detaje për këtë aktiviteti do të jepen së shpejti nga Bashkia Pogradec dhe Q.M.P përkatëse nëpërmjet website dhe facebook.

## **DORËZIMI I APLIKIMEVE:**

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen në tri (3) kopje të shtypura dhe një kopje elektronike (CD apo USB), të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte), nga ora 09:00 deri ora 15:00, në adresat në vijim:

**Bashkia Pogradec, Pogradec ose Shoqeria Qendra Multifunkionale Pogradec sh.a, me adrese tek Pallati i Kultures, Kati II.**

**Afati përfundimtar, për dorëzimin e aplikimeve është data 03/10/2022, ora 15:00.**

Aplikimet e dorëzuara pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar.

Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për dorëzimin e propozimeve, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, emrin e plotë të projektit dhe mbishkrimin “Të mos hapet përpara hapjes zyrtare.” Formulari për regjistrimin e dokumentacionit të pranuar lëshohet nga përfaqësuesi i bashkisë.

Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i procesit të vleresimit.

Procesi i vleresimit zgjat maksimalisht 5 dite pune, nga mbyllja e thirrjes.

Rezultatet do të njoftohen në mënyrë individuale sipas adreses së vendosur në projekt propozim.

Shenim: Jini të lutur të paraqesni adresën në saktë në aplikim, pasi do të shërbejnë për komunikim zyrtar.

Ju Faleminderit!

**QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC SH. A**

**ADMINISTRATORI**  
**Alma KANINA**

